

PROMOVIMI I PARANDALIMIT DHE RICIKLIMIT TË MBETURINAVE NË ZONËN NDËRKUFITARE (LESS WASTE II)

Kontekst

Menaxhimi i mbetjeve në zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri është problem i përbashkët. Sasia e mbetjeve të ngurta bashkiake që gjenerohet në Shqipëri është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit dhe nevoja për të përmirësuar menaxhimin e tyre është evidente. Në Greqi, Planet e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (MIM) janë zhvilluar, por ndarja në burim e mbetjeve të biodegradueshme është ende e kufizuar. Qëllimi i projektit Less Waste II ishte promovimi i kompostimit/riciklimit në zonën ndërkufitare duke zhvilluar plane veprimi në të dy vendet. U zhvilluan tre sisteme (dy në Greqi dhe një në Shqipëri) për ndarjen në burim të mbetjeve shtëpiake të biodegradueshme dhe vajrave të gatimit (vetëm në Greqi). Projekti gjithashtu inkurajoi pjesëmarrjen e qytetarëve në grumbullimin e mbetjeve biologjike përmes aktiviteteve trajnuese ku dhe u zhvilluan sesione informuese.


Objektivat e Projektit

Objektivat specifike të këtij projekti janë:

- Adresimi i nevojës për strategji të menaxhimit të mbetjeve duke kombinuar veprimet vendore dhe rajonale që reduktojnë volumin e mbetjeve që shkojnë në vendgrumbullime;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, prezantimi i kompostimit në shtëpi dhe ndarjes në burim përmes sigurimit të pajisjeve të nevojshme dhe materialeve të diseminimit;
- Demonstrimi i mënyrave të qëndrueshme të ripërdorimit të mbetjeve biologjike nëpërmjet trajnimeve dhe demonstrimit të pajisjeve;
- Përfshirja e qytetarëve, veçanërisht të rinjve, në trajnimet për ndarjen e mbetjeve në shtëpi;
- Rritja e ndërgjegjësimit për ekonominë qarkulluese.

Produktet

- Plan për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve për Bashkinë Skrapar me strategji diseminimi dhe plan veprimi;
- Plan Veprimi për strategjitë e parandalimit të mbetjeve ndërkufitare;
- Studim fizibiliteti për skenarët e reduktimit dhe ripërdorimit të mbetjeve;
- Identifikimi i vendndodhjes më të përshtatshme për ndërtimin e Qendrës Multifunkionale për MIM dhe kryerja e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- Harta GIS e sistemit të mbetjeve bashkiake;
- Krijimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të bazuar në performancë;
- Trajnim i stafit në bashki për përdorimin e sistemit të monitorim-vlerësimit;
- Udhëzues për parandalimin, ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve;
- Shpërndarja e 40 koshave për kompostimin e mbetjeve si pjesë e Planit Pilot për Kompostimin.



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Komisioni Evropian

PARTNERËT:

- Menaxhimi i Mbetjeve i Maqedonisë Perëndimore S.A
- Qendra për Hulumtim dhe Teknologji Hellas
- Bashkia Grevena, Greqi
- Bashkia Kastoria, Greqi
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)
- Bashkia Skrapar

KOHËZGJATJA:

01/04/2018 - 15/12/2021

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.



CERTH
CENTRE FOR
RESEARCH & TECHNOLOGY
HELLAS



MUNICIPALITY
OF KASTORIA